



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 148

21 nëntor

2012

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr. 107/2012 datë 8.11.2012	Për dhënie amnistie 8137
Vendim i Kuvendit nr. 46/2012, datë 8.11.2012	Për mosmiratimin e kërkesës së një grupi deputetësh “Për ngritjen e komisionit hetimor për kontrollin e zbatimit të ligjit në veprimtarinë e Ministrisë së Mbrojtjes dhe strukturave në varësi të saj për periudhën janar 2010 – tetor 2012” 8139
Vendim i KM nr. 745, datë 24.10.2012	Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të cilat zotërohen dokumente të ligjshme pronësie, por që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen 8140
Vendim i KM nr. 746, datë 24.10.2012	Për miratimin e ndryshimit të statusit të institucionit privat të arsimit të lartë “Shkolla e lartë private “Universiteti Polis”” 8142
Vendim i KM nr. 747, datë 24.10.2012	Për shpalljen, kategorizimin dhe emërtimin e portit të mallrave “Limjon - Sarandë” si “Port i hapur për trafik ndërkombëtar” 8142
Vendim i KM nr. 751, datë 2.11.2012	Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për procedurën e bashkëpunimit dhe të bashkërendimit të veprimtarisë së Ministrisë së Drejtësisë me institucionet e tjera shtetërore, që trajtojnë çështjet e të drejtave të pronësisë 8143
Vendim i KM nr. 752, datë 2.11.2012	Për përcaktimin e procedurës dhe të kriterëve për caktimin e anëtarëve të bordit drejtues të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, si dhe të masës së shpërblimit të tyre 8146

Vendim i KM nr. 753, datë 2.11.2012	Për miratimin në parim të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për transferimin e personave të dënuar	8148
Vendim i KM nr. 756, datë 6.11.2012	Për lirim dhe emërimin në detyrë të drejtorit të përgjithshëm të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit	8154
Vendim i KM nr. 758, datë 2.11.2012	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për veprimtaritë e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, dhe për organizimin e ekspozitës “Veshje të trevave shqiptare” në kuadër të 100-Vjetorit të Pavarësisë	8154
Vendim i KM nr. 768, datë 7.11.2012	Për përcaktimin e rregullave dhe të kriterëve për shpërndarjen e fondit të kompensimit pronarëve, në të holla, për vitin 2012	8155
Vendim i KM nr. 801, datë 14.11.2012	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për realizimin e tri koncerteve, më 28 nëntor 2012, me rastin e 100-Vjetorit të Pavarësisë.....	8160
Kërkesë e MPPT nr. 4675, datë 8.11.2012	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Tiranë-Elbasan” (loti I + loti III): kultura bujqësore, dru frutorë dhe dru dekorativë	8161

LIGJ
Nr. 107/2012

PËR DHËNIE AMNISTIE

Në mbështetje të neneve 81 pikat 1 e 2 shkronja “ë” dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Qëllimi dhe parimet e ligjit

1. Qëllimi i këtij ligji është të përjashtojë nga ndjekja penale, nga vuajtja tërësisht ose pjesërisht e dënimit të gjithë personat që plotësojnë kriteret sipas dispozitave të këtij ligji.

2. Dhënia e amnistisë udhëhiqet nga parimet e humanizmit, arritjes së qëllimit të dënimit, rrezikshmërisë së ulët të personave që amnistohen, si dhe mbrojtjes së interesit publik.

Neni 2
I dënuar

I dënuar, në kuptim të këtij ligji, konsiderohet personi i dënuar nga gjykata me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Neni 3
Kriteret për përfitimin e amnistisë

1. Plotësojnë kriteret për të përfituar amnisti, sipas këtij ligji:

a) personat e dënuar me burgim deri në 2 vjet, për dënime të dhëna deri në datën 30 shtator 2012, pavarësisht kohës së mbetur nga dënimi, me përjashtim të personave të dënuar për veprat penale të parashikuara në nenin 4 të këtij ligji;

b) personat e dënuar, ndaj të cilëve gjykata, me vendim të formës së prerë, ka caktuar një nga llojet e alternativave të dënimit me burgim, me përjashtim të personave të dënuar për veprat penale të parashikuara në nenin 4 të këtij ligji;

c) personat e dënuar me gjobë, për pjesën e pashlyer të saj, pavarësisht masës së gjobës, me përjashtim të personave të dënuar për veprat penale të parashikuara në nenin 4 të këtij ligji;

ç) personat e dënuar me burgim, të cilëve, në datën 28 nëntor 2012, u kanë mbetur pa vuajtur nga ky dënim deri në 1 vit, me përjashtim të personave të dënuar për veprat penale të parashikuara në nenin 4 të këtij ligji;

d) të dënuarat femra, që në datën 28 nëntor 2012 janë baras ose mbi moshën 55 vjeç, me përjashtim të personave të dënuar për veprat penale të parashikuara në nenin 4 të këtij ligji;

dh) të dënuarit meshkuj, që në datën 28 nëntor 2012 janë baras ose mbi moshën 60 vjeç, me përjashtim të personave të dënuar për veprat penale të parashikuara në nenin 4 të këtij ligji;

e) të dënuarit me burgim, të cilët, në kohën e kryerjes së veprës penale, kanë qenë baras ose nën moshën 18 vjeç, me përjashtim të atyre, që janë dënuar për vepra penale, të parashikuara në nenet 76, 77, 78, 79, 101, 139, 140 e 141 të Kodit Penal.

2. Të gjithë të dënuarve që nuk plotësojnë kriteret për të përfituar amnisti, sipas paragrafit 1 të këtij neni, u zbritet 1/4 e dënimit të mbetur, me përjashtim të personave të dënuar për veprat penale të



parashikuara në nenin 4 të këtij ligji. Në rastin e personave përsëritës, të dënuar për të njëjtën vepër penale, nuk zbatohet zbritja sipas këtij paragrafi.

Neni 4

Kriteri ndalues për përfitimin e amnistisë

1. Nuk përfitojnë nga kjo amnisti personat e dënuar për:
 - a) krime kundër njerëzimit, të parashikuara në nenet 73, 74 e 75 të Kodit Penal;
 - b) krime kundër jetës, të kryera me dashje, të parashikuara në nenet 76 , 77, 78 dhe 79 të Kodit Penal dhe vrasje e mbetur në tentativë, si dhe neni 77 i Kodit Penal Ushtarak;
 - c) vepra penale, të kryera me dashje, kundër shëndetit, të parashikuara në nenet 86, 87, paragrafi i dytë i nenit 88, dhe 89/a të Kodit Penal;
 - ç) krime seksuale, të parashikuara në nenet 100, 101, 102, 102/a, 103, 104, 106 dhe 108 të Kodit Penal;
 - d) vepra penale kundër lirisë së personit, të parashikuara në nenet 109, paragrafi i dytë dhe i tretë i nenit 109/b, paragrafi i parë i nenit 110, 110/a dhe 111 të Kodit Penal;
 - dh) vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit, të parashikuara në nenet 114, 114/a, 114/b dhe në paragrafin e dytë të nenit 117 të Kodit Penal;
 - e) vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, të parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 124, paragrafin e tretë të nenit 124/b, nenet 128/a dhe 128/b të Kodit Penal;
 - ë) vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, të parashikuara në nenet 135, 136, paragrafi i dytë i nenit 138, 138/a, 139, 140, 141, paragrafi i dytë i nenit 141/a, paragrafi i dytë i nenit 143, 143/a, paragrafi i tretë i nenit 152, dhe 175 të Kodit Penal, si dhe në paragrafin e dytë dhe të tretë të nenit 59 të Kodit Penal Ushtarak;
 - f) krime kundër pavarësisë dhe rendit kushtetues, të parashikuara në nenet 208, 209, 210, 211, 212, 213, 214, 215, 216, 217, 218, 219, 220, 221, 222, 223, 224 e 225 të Kodit Penal;
 - g) krime që cenojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera, të parashikuara në nenet 226 e 228 të Kodit Penal;
 - gj) vepra me qëllime terroriste, të parashikuara në nenet 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 231, 232, 233, 234, 234/a e 234/b të Kodit Penal;
 - h) krime kundër autoritetit të shtetit, të parashikuara në nenet 244, 244/a, 245, 245/1, 248, 250, 258, 259, 259/a, 260, 270, paragrafi i parë dhe i katërt i nenit 278, 278/a, paragrafi i dytë i nenit 282, 282/a, 283, 283/a, 283/b, 284, 284/a, 284/c, 284/ç, 286, 287, 287/a, 288, paragrafi i dytë i nenit 289, 290, si dhe paragrafët e dytë, të tretë, të katërt dhe të pestë të nenit 298 të Kodit Penal;
 - i) vepra penale kundër drejtësisë, të parashikuara në nenet 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh e 319/e të Kodit Penal;
 - j) vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, të parashikuara në nenet 325, 326, 326/a, 327, 327/a, 328, 328/a, 329, 330, 330/a, 331 dhe 332 të Kodit Penal;
 - k) vepra penale të kryera nga banda e armatosur dhe organizata kriminale, të parashikuara në nenet 333, 333/a dhe 334 të Kodit Penal.
2. Nuk përfitojnë nga kjo amnisti personat e dënuar, që i janë shmangur ekzekutimit të dënimit të dhënë.

Neni 5

Pushimi i ndjekjes penale

1. Procedimi penal nuk mund të fillojë dhe nëse ka filluar duhet të pushojë për veprat penale të kryera deri në datën 30 shtator 2012, për të cilat Kodi Penal parashikon një dënim me burgim deri në 2 vjet ose çdo lloj dënimi tjetër më të lehtë.
2. Sipas kompetencës së dhënë nga Kodi i Procedurës Penale dhe në varësi të fazës apo të shkallës së procedimit penal, prokurori ose gjykata vendosin mosfillimin e çështjes penale apo pushimin e çështjes penale për veprat penale që amnistohen.

Neni 6
Dispozitë zbatuese

Ngarkohen Ministri i Drejtësisë, Ministri i Brendshëm, Ministri i Mbrojtjes dhe Prokurori i Përgjithshëm për zbatimin e këtij ligji.

Neni 7
Hyrja në fuqi

Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi në datën 28 nëntor 2012.

Miraturar në datën 8.11.2012

**Shpallur me dekretin nr. 7824, datë 19.11.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

VENDIM
Nr. 46/2012

**PËR MOSMIRATIMIN E KËRKESËS SË NJË GRUPI DEPUTETËSH “PËR NGRITJEN E
KOMISIONIT HETIMOR PËR KONTROLLIN E ZBATIMIT TË LIGJIT NË VEPRIMTARINË
E MINISTRISË SË MBROJTJES DHE STRUKTURAVE NË VARËSI TË SAJ PËR PERIUdhËN
JANAR 2010 – TETOR 2012”**

Në mbështetje të nenit 78 pika 2 të Kushtetutës, nenit 4 pika 1 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, si dhe vendimeve nr. 18, datë 14.5.2003, nr. 26, datë 4.12.2006, nr. 20, datë 4.5.2007, nr. 12, datë 20.5.2008 dhe nr. 22, datë 5.5.2010 të Gjykatës Kushtetuese,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Mosmiratimin e kërkesës së një grupi deputetësh “Për ngritjen e komisionit hetimor për kontrollin e zbatimit të ligjit në veprimtarinë e Ministrisë së Mbrojtjes dhe strukturave në varësi të saj për periudhën janar 2010 – tetor 2012”, për shkak se objekti i punës së këtij komisioni, i propozuar në këtë kërkesë, është në kundërshtim me nenin 77 pika 2 të Kushtetutës, si dhe vendimet nr. 18, datë 14.5.2003, nr. 26, datë 4.12.2006, nr. 20, datë 4.5.2007, nr. 12, datë 20.5.2008 dhe nr. 22, datë 5.5.2010 të Gjykatës Kushtetuese.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Miraturar në datën 8.11.2012



VENDIM
Nr. 745, datë 24.10.2012

**PËR PROCEDURAT E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PËR TË CILAT
ZOTËROHEN DOKUMENTE TË LIGJSHME PRONËSIE, POR QË NUK KANË TË
PËRCAKTUAR SIPËRFAQEN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b” të nenit 25 të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Objekt i këtij vendimi është përcaktimi i procedurave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të cilat zotërohen dokumente të ligjshme pronësie, por që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen.

2. Pasuritë e paluajtshme, që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen, të cilat ndodhen në zona kadastrale, për të cilat, në çastin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, nuk ka përfunduar procesi i regjistrimit fillestar të pasurive ose ky proces është duke u zhvilluar, nuk mund të regjistrohen në një kartelë dhe hartë kadastrale, në emër të pronarit, pa u zhvilluar më parë procedura e regjistrimit të tyre, e përcaktuar në këtë vendim.

3. Pasuritë e paluajtshme, për të cilat, në çastin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, ndodhen të pozicionuara, gjeografikisht, në zona kadastrale, për të cilat ka përfunduar regjistrimi fillestar, gjatë të cilit sipërfaqja dhe pozicioni gjeografik i tyre është përcaktuar nga matjet në terren dhe pasuritë janë regjistruar në një kartelë dhe hartë kadastrale në emër të pronarit, do të vlerësohen se e kanë të përcaktuar sipërfaqen, pa qenë e nevojshme të zhvillohet procedurë fillestare, sipas shkronjës “b” të nenit 25 të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me kusht që, gjatë periudhës së afishimit publik të mos ketë asnjë pretendim të pazgjidhur për pozicionimin e pasurisë, kufijtë dhe sipërfaqen. Për pasuritë e paluajtshme, të cilat, në çastin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, ndeshen të pozicionuara, gjeografikisht, në zonat kadastrale për të cilat ka përfunduar regjistrimi fillestar, por që janë regjistruar në kartelën e pasurisë së paluajtshme me shënimin “shtet” apo “pronar i pavërtetuar”, nuk mund të procedohet me regjistrimin e tyre në favor të pronarit, pa u zhvilluar më parë procedura e regjistrimit të tyre, e përcaktuar në këtë vendim.

4. Regjistrimi i pasurive të paluajtshme, të përcaktuara në këtë vendim, bëhet me kërkesë të personit të interesuar. Ai duhet ta provojë pronësinë me dokumentet e pronësisë në kuptim të nenit 193 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, duke paraqitur tek regjistruesi këto dokumente:

a) aktin e fitimit të pronësisë, në rastet kur pasuria e paluajtshme regjistrohet për herë të parë, ose dokumentin e regjistrimit, në rastet kur pasuria e paluajtshme figuron e regjistruar në regjistrat hipotekorë;

b) një plan rilevimi të pasurisë së paluajtshme, të përgatitur nga një subjekt i licencuar për punime topografike apo nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, sipas kërkesës së të interesuarit;

c) deklaratën noteriale të pronarëve kufitarë, që vërtetojnë përmbajtjen e kërkesës për kufijtë e pasurisë, që pretendohet të regjistrohet;

ç) dokumentacionin nga arkivi teknik i ndërtimit, që pasqyron hartografisht gjendjen e pasurisë që pretendohet, në rast se disponohet nga ky arkiv;

d) mandatpagesën e shpenzimeve të regjistrimit (tarifa, taksa, shpenzime të tjera, nëse ka të tilla).

5. Kur në kufi të pronës, për të cilën është paraqitur kërkesë regjistrimi, janë prona shtetërore, si: rrugë, rrugica, sheshe publike, lulishte, ndërtesa publike etj., deklarata noteriale zëvendësohet nga konfirmimi zyrtar i dhënë nga institucioni, i cili është pronar apo administron pronën shtetërore.

6. Kur në kufi të pronës janë prona të individëve, persona fizikë apo juridikë, privatë a shtetërorë, të cilët nuk e kanë të regjistruar pasurinë në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, deklarata noteriale e pronarit të pronës kufitare do të zëvendësohet nga një deklaratë noteriale e bërë nga këta persona, në cilësinë e poseduesit të pasurisë kufitare, të pasqyruar në kartelë si “pronar i pavërtetuar”. Në këtë rast, përveç deklaratës noteriale të poseduesit të pasurisë kufitare, zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZRPP) procedon edhe me shpalljen e planit të rievimit të pasurisë, sipas procedurës së parashikuar në pikën 7 të këtij vendimi.

7. Kur deklarata e pronarëve kufitarë të pasurisë, për të cilën kërkohet regjistrimi me përcaktimin e sipërfaqes, sipas shkronjës “b” të nenit 25 të ligjit nr. 33/2012, për arsye të ndryshme, objektive, me përjashtim të pretendimeve për kufirin e pasurisë, nuk është bërë e mundur të sigurohet, ZRPP-ja afishon për publikun planin e rievimit të pasurisë apo dokumente hartografike, për një periudhë prej 45 ditësh, në mjedise të dukshme të ZRPP-së dhe të njësisë bashkiake, në territorin e së cilës ndodhet pasuria.

Për zhvillimin e procedurës së afishimit është e nevojshme që kufiri i pasurisë, për të cilin mungon deklarata e pronarit/poseduesit kufitar të përputhet me kufirin që tregojnë dokumentet hartografike të marra nga arkivi teknik i ndërtimit. Në rast se ky kufi nuk përputhet, nuk zhvillohet procedura e afishimit dhe nga regjistruesi refuzohet regjistrimi.

8. Kërkuesi nënshkruan një deklaratë para noterit, me të cilën vërteton, në përgjegjësinë e vet, se nuk ka mundur, për arsye objektive, të sigurojë deklaratën noteriale të pronarit apo të pronarëve kufitarë me pasurinë, që kërkon të regjistrojë, si dhe natyrën e pamundësisë objektive. Në rast se pronari kufitar, brenda afatit prej 45 ditësh, paraqet në ZRPP ankesë apo pretendim të argumentuar e të mbështetur në dokumente ligjore për kufijtë e pasurisë, për të cilën kërkohet të bëhet regjistrimi, regjistruesi refuzon regjistrimin.

Në rast se nga pronari kufitar nuk paraqitet në ZRPP, brenda afatit prej 45 ditësh, ankesë apo pretendim për kufijtë e pasurisë, për të cilën kërkohet të bëhet regjistrimi, regjistruesi, brenda 5 ditëve pune nga data e përfundimit të afatit të mësipërm, harton, në dy kopje, një procesverbal, i cili përmban një përshkrim të procedurave të kryera. Një kopje e procesverbalit depozitohet në arkivin e ZRPP-së, ndërsa kopja tjetër administrohet në dosjen e kërkuesit të regjistrimit të pronës.

9. Kur pronën kufitare e kanë në pronësi dy a më shumë bashkëpronarë, kërkuesi paraqet deklaratat noteriale të bashkëpronarëve, për të cilët është e mundur marrja e kësaj deklarate. Për bashkëpronarët e tjerë, për të cilët nuk është e mundur objektivisht marrja e deklaratës noteriale, zbatohen procedurat e përcaktuara në pikën 7 të këtij vendimi.

10. Procedurat e parashikuara në pikat 7, 8 dhe 9 të këtij vendimi, zbatohen në çdo rast tjetër të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të cilin nevojiten deklaratat e pronarëve kufitarë.

11. Regjistruesi, nëse e gjykon të nevojshme, në zbatim të nenit 20 të ligjit nr. 33/2012, verifikon vërtetësinë e dokumentacionit të paraqitur nga kërkuesi. Për këtë qëllim, ai ka të drejtë të kërkojë dokumente nga të tretët, persona, fizikë ose juridikë, zyrat e noterisë dhe organe të administratës. Përveç verifikimit të vërtetësisë së dokumentacionit, nëse e gjykon të nevojshme, regjistruesi mund të urdhërojë verifikimin në terren të pasurisë, me një grup të përbërë nga të paktën, 2 punonjës hartografë të zyrës së regjistrimit, për të bërë matjet dhe për të hartuar dokumentet përkatëse (planvendosje/genplan/planrilevimi).

12. Regjistruesi, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së kërkesës, me përjashtim të rasteve të afishimit të parashikuara në pikën 7 të këtij vendimi, merr vendim për regjistrimin ose refuzimin e regjistrimit të pasurisë. Kundër vendimit të regjistruesit ose në mungesë të përgjigjes, kërkuesi mund të ankohet në gjykatë.

13. Regjistruesi, në dhënien e vendimit për regjistrim ose refuzim regjistrimi, mbështetet në:

a) dokumentacionin e paraqitur nga kërkuesi;

b) verifikimet e kryera prej tij, në zbatim të nenit 20 të ligjit nr. 33/2012 dhe të pikës 4 të këtij vendimi.



14. Vendimi i regjistruesit duhet të jetë në formë të shkruar, i arsyetuar, i nënshkruar dhe të përmbushë kërkesat për aktin administrativ të parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë.

15. Zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për qëllime kompetence, publikon në faqen zyrtare të internetit dhe në ambientet e njoftimeve çdo vendim të marrë gjatë kësaj procedure.

16. Vendimi nr. 1025, datë 9.7.2008 “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të cilat zotërohen dokumente të ligjshme pronësie, por që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen”, shfuqizohet.

17. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr. 746, datë 24.10.2012

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT TË INSTITUCIONIT PRIVAT TË ARSIMIT TË LARTË “SHKOLLA E LARTË PRIVATE “UNIVERSITETI POLIS””

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, 5 e 43 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit të institucionit privat të arsimit të lartë “Shkolla e lartë private “Universiteti Polis””, nga shkollë e lartë universitare në universitet.

2. Ky institucion privat i arsimit të lartë ruan akreditimin institucional dhe të programeve të studimit të fituar para hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në këtë institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr. 747, datë 24.10.2012

PËR SHPALLJEN, KATEGORIZIMIN DHE EMËRTIMIN E PORTIT TË MALLRAVE “LIMJON - SARANDË” SI “PORT I HAPUR PËR TRAFIK NDËRKOMBËTAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7 të nenit 18 të ligjit nr.9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen, kategorizimin dhe emërtimin e portit detar të mallrave “Limjon - Sarandë” si “Port i hapur për trafik ndërkombëtar”, i cili ka specifikat, si më poshtë vijon:

Koordinatat gjeografike	N : 39°52'19.41" L : 19°59'24.83"
Veprimtaria detare	Ngarkim - shkarkim mallrash
Operativiteti	Port i hapur për trafik ndërkombëtar, 24 orë
Shfrytëzimi	Pronë e shtetit shqiptar dhe e lirë për t'u shfrytëzuar sipas vullnetit të shtetit
Menaxhimi	Shteti shqiptar, përfaqësuar nga organet qendrore përgjegjëse në fushën e porteve dhe të zhvillimit ekonomik
Administrimi	Në varësi administrative të "Portit Detar", sh.a., Sarandë
Pronësia	Shteti shqiptar i përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
Marrëdhënia me institucionin përgjegjës për transportin	Raportim periodik për vëllimin e punës së kryer në port
Detyrime të tjera	Person kontakti dhe adresë kontakti në çdo kohë. Faqe zyrtare në gjuhën shqipe dhe në anglisht që përmban informacion të plotë për rregullat e funksionimit të portit, tarifat dhe normat ditore të ngarkim-shkarkimit, si dhe informacion për situatën e anijeve në port.

2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Punëve Publike dhe Transportit të marrin masa që, në bashkëpunim me drejtuesit e portit, të bëjnë funksionale të gjitha strukturat përkatëse shtetërore, përfshirë komunikimin nominal të personave që do t'i ushtrojnë këto funksione në port.

3. Porti do të bëhet funksional (operativ) pas plotësimit të detyrimeve të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 751, datë 2.11.2012

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR PROCEDURËN E BASHKËPUNIMIT DHE TË BASHKËRENDIMIT TË VEPRIMTARISË SË MINISTRISË SË DREJTËSISË ME INSTITUCIONET E TJERA SHTETËRORE, QË TRAJTOJNË ÇËSHTJET E TË DREJTAVE TË PRONËSISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 28/4 të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Drejtësisë, nëpërmjet Drejtorisë së Koordinimit të Çështjeve të Pronësisë, mbështet, bashkëpunon dhe bashkërendon punët e saj me institucionet e tjera shtetërore të përfshira në procesin e njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronave, sipas përcaktimeve të nenit 28/4 të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar, si dhe të vendimit nr. 405, datë 27.6.2012 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale, "Reforma në fushën e të drejtave të pronësisë 2012-2020" dhe të planit të saj të veprimit".



2. Ministria e Drejtësisë, me qëllim garantimin dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe legjislacionit në fuqi që rregullon çështjet e të drejtave të pronësisë, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj udhëhiqet nga parimet:

- a) e ligjshmërisë dhe mbrojtjes të të drejtave të pronësisë;
- b) e sigurisë juridike;
- c) e transparencës;
- ç) e frytshmërisë dhe efektivitetit;
- d) e garantimit të dhe shkëmbimit të informacionit.

3. Ministria e Drejtësisë bashkëpunon dhe bashkërendon veprimtarinë e saj me:

- a) Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave;
- b) Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta;
- c) Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;
- ç) Agjencinë e Legalizimit, Urbanizimit, Integritetit të Zonave dhe Ndërtimeve Informale ose

drejtoritë rajonale të saj;

- d) Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit;
- dh) Agjencinë e Inventarizimit të Transferimit të Pasurive të Paluajtshme;
- e) Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave;
- ë) Avokaturën e Shtetit, në nivel qendror dhe vendor;
- f) Autoritetin Shtetëror të Informacionit Gjeohapësinor;
- g) Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjeve të Pronave Publike;
- gj) Drejtorinë e Privatizimit;
- h) Drejtorinë e Turizmit;
- i) Entin Kombëtar të Banesave;
- j) Komisionin Qeveritar të Tokës apo me sekretariatit teknik të tij;
- k) Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor, në nivel qendror dhe vendor;
- l) Njësitë e qeverisjes vendore;
- ll) Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në nivel qendror dhe vendor;
- m) Çdo institucion tjetër shtetëror që trajton çështjet e të drejtave të pronësisë.

4. Procedurat e bashkëpunimit dhe të bashkërendimit të veprimtarisë së Ministrisë së Drejtësisë me institucionet që trajtojnë çështjet e të drejtave të pronësisë përfshijnë:

a) dhënien dhe shkëmbimin e informacionit apo të dokumentacionit të kërkuar që lidhen me procesin e njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronave;

b) dhënien dhe shkëmbimin e informacionit apo të dokumentacionit të kërkuar që lidhen me zbatimin e masave strategjike të parashikuara në vendimin nr. 405, datë 27.6.2012 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strategjisë ndësektoriale “Reforma në fushën e të drejtave të pronësisë, 2012-2020” dhe të planit të saj të veprimit”;

c) dhënien dhe shkëmbimin e informacionit apo të dokumentacionit të kërkuar për çështje që lidhen me të drejtat e pronësisë dhe që janë të nevojshme për përmbushjen nga Ministria e Drejtësisë të përgjegjësi të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

5. Çdo institucion shtetëror, që trajton çështjet e të drejtave të pronësisë, të parashikuara në pikën 3 të këtij vendimi, paraqet pranë Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Koordinimit të Çështjeve të Pronësisë, informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar:

a) brenda 5 (pesë) ditëve nga data e nxjerrjes së aktit apo e disponimit të informacionit, në rastet kur vlerësohet se ky informacion është i nevojshëm për përmbushjen nga Ministria e Drejtësisë të përgjegjësi të parashikuara në nenin 28/4 të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004, të ndryshuar;

b) brenda 10 (dhjetë) ditëve nga momenti i administrimit të kërkesës së paraqitur me shkrim në rrugë zyrtare nga Ministria e Drejtësisë;

c) çdo katër muaj, me ose pa kërkesën me shkrim në rrugë zyrtare nga Ministria e Drejtësisë, për sa i përket ecurisë së proceseve që lidhen me të drejtat e pronësisë, si dhe zbatimit të masave strategjike, të parashikuara në vendimin nr. 405, datë 27.6.2012 të Këshillit të Ministrave;

ç) çdo fund viti, me ose pa kërkesën me shkrim në rrugë zyrtare nga Ministria e Drejtësisë, për sa i përket analizës vjetore për ecurinë e proceseve që lidhen me të drejtat e pronësisë, si dhe zbatimit të masave strategjike, të parashikuara në vendimin nr. 405, datë 27.6.2012 të Këshillit të Ministrave.

6. Informacioni apo dokumentacioni i kërkuar sipas afateve të përcaktuara në pikën 5 të këtij vendimi, i dërgohet Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Koordinimit të Çështjeve të Pronësisë, me shkrim në rrugë zyrtare, i nënshkruar nga titullari i institucionit.

7. Informacioni i dërguar duhet të përmbajë veçanërisht të dhëna për:

a) evidentimin e problematikave të konstatuara gjatë ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësi të tyre;

b) statusin e çështjeve të trajtuara duke përfshirë dhe analizën ligjore;

c) statusin e çështjeve të trajtuara me argumentimin për mostrajtimin e tyre;

ç) paraqitjen e propozimeve apo të sugjerimeve për zgjidhjen e problematikave të konstatuara gjatë procesit të njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronave, reformave në fushën e të drejtave të pronësisë dhe në funksion të zbatimit të masave strategjike, të parashikuara në vendimin nr. 405, datë 27.6.2012 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale “Reforma në fushën e të drejtave të pronësisë, 2012-2020”, dhe të planit të saj të veprimit”;

d) çdo të dhënë tjetër që lidhet me rregullimin e çështjeve të të drejtave të pronësisë sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

8. Nëse gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, Ministria e Drejtësisë, nëpërmjet Drejtorisë së Koordinimit të Çështjeve të Pronësisë, konstaton shkelje të afateve të përcaktuara në pikën 5 të këtij vendimi, ose shkelje ligjore sipas legjislacionit në fuqi për funksionimin e veprimtarisë së institucioneve shtetërore që trajtojnë çështjet e të drejtave të pronësisë, merr masat e mëposhtme:

a) Për institucionet në varësi të saj, i raporton Ministrinë të Drejtësisë, me qëllim disiplinimin apo përmirësimin e veprimtarisë së tyre, si dhe marrjen e masave disiplinore për personat përgjegjës, sipas legjislacionit në fuqi.

b) Për institucionet të cilat nuk janë në varësi të saj, i raporton organit epror të institucionit që trajton çështjet e të drejtave të pronësisë, me qëllim disiplinimin apo përmirësimin e veprimtarisë së tyre, duke propozuar, sipas rastit, edhe marrjen e masave disiplinore për personat përgjegjës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

9. Ministria e Drejtësisë, në funksion të rolit të saj për çështjet e pronësisë, si dhe në vijim të informacioneve dhe dokumentacioneve të marra nga institucionet e përmendura në pikën 3 të këtij vendimi, realizon këto përgjegjësi:

a) Harton programe apo rekomandime për marrjen e masave ligjore dhe ekzekutive në fushën e mbrojtjes së çështjeve të të drejtave të pronësisë, duke monitoruar procesin e njohjes së kthimit dhe të kompensimit të pronave, si dhe zbatimit të masave strategjike, të parashikuara në vendimin nr. 405, datë 27.6.2012 të Këshillit të Ministrave;

b) Përgatit analizën tekniko-ligjore të vlerësimit të efektivitetit të legjislacionit në fuqi për çështjet e të drejtave të pronësisë;

c) Kryen studime dhe paraqet propozime për përmirësimin e legjislacionit në fuqi që rregullon çështjet e të drejtave të pronësisë;

ç) Evidenton problematikat e konstatuara gjatë ushtrimit të veprimtarisë së institucioneve shtetërore që trajtojnë çështjet e të drejtave të pronësisë, në kuadër të procesit të njohjes, kthimit e kompensimit të pronave, si dhe të zbatimit të masave strategjike dhe paraqet propozime për zgjidhjen e tyre;

d) Kujdeset për grumbullimin, përpunimin, transmetimin e ndërsjellë të informacionit apo dokumentacionit ndërmjet institucioneve shtetërore që trajtojnë çështjet e të drejtave të pronësisë, në kuadër të procesit të njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronave, të reformave në fushën e të drejtave të pronësisë, si dhe të zbatimit të masave strategjike;

dh) Kujdeset për mbajtjen, administrimin, përditësimin, përpunimin e të dhënave statistikore për procesin e njohjes, kthimit e kompensimit të pronave dhe të zbatimit të masave strategjike, të parashikuara në vendimin nr. 405, datë 27.6.2012 të Këshillit të Ministrave;



e) Mbledh, përpunon, analizon informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar dhe i paraqet Këshillit të Ministrave, në formën e një raporti përfundimtar, propozime për përmirësimin e mënyrës së trajtimit të çështjeve të drejtave të pronësisë;

ë) Ndjek, realizon, zbaton çdo detyrë tjetër të përcaktuar në akte, ligjore apo nënligjore, në fuqi.

10. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministria e Brendshme, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Bujqësisë Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Turizmit, Kulturës Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, njësitë e qeverisjes vendore dhe Komisioni Qeveritar i Tokës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 752, datë 2.11.2012

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS DHE TË KRITEREVE PËR CAKTIMIN E ANËTARËVE TË BORDIT DREJTUES TË ZYRËS SË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, SI DHE TË MASËS SË SHPËRBLIMIT TË TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 12 të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Dispozita të përgjithshme

1. Objekt i këtij vendimi është përcaktimi i procedurës dhe i kriterëve për caktimin e anëtarëve të bordit drejtues të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, si dhe i masës së shpërblimit të tyre.

2. Bordi drejtues i Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, prej të cilëve 2 (dy) të caktuar nga Kryeministri, 2 (dy) të caktuar nga Ministri i Drejtësisë, dhe 1 (një) i caktuar nga Ministri i Financave.

3. Caktimi i anëtarëve të bordit drejtues të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme bëhet duke mbajtur në konsideratë përgjegjësitë që secili anëtar duhet të përmbushë gjatë veprimtarisë së tij si anëtar i këtij bordi.

4. Anëtarët e bordit drejtues, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, udhëhiqen nga parimet e përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative dhe neni 4 i ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

5. Bordi drejtues është organ kolegjal, që funksionon me kohë të pjesshme dhe në përputhje me rregullat e legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e organeve kolegjiale të administratës publike.

6. Bordi drejtues, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, ndihmohet nga një sekretariat teknik, i përbërë nga 3 (tre) punonjës të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të caktuar nga ky bord, me propozimin e Kryeregjistruesit.

7. Rregullat e hollësishme për funksionimin e bordit drejtues dhe mënyra e ushtrimit të përgjegjësiave ligjore të tij përcaktohen në rregulloren e brendshme të funksionimit të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, që miratohet me vendim të bordit drejtues, me propozim të Kryeregjistruesit.

II. Procedura e caktimit të anëtarëve të bordit drejtues

1. Caktimi i anëtarëve të bordit drejtues bëhet, respektivisht, nga Kryeministri, Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Financave, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga krijimi i vendit vakant.

2. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme njofton menjëherë Ministrin e Drejtësisë për vendet e vakante të krijuara, duke propozuar edhe vijimin e procedurave për caktimin e anëtarit të ri.

3. Ministri i Drejtësisë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga krijimi i vendit vakant, cakton anëtarin e ri të bordit drejtues, nëse caktimi është kompetencë e tij. Nëse caktimi i anëtarit të ri është kompetencë e Kryeministrit ose Ministrit të Financave, Ministri i Drejtësisë, brenda 3 (tri) ditëve nga marrja e njoftimit nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, njofton Kryeministrin ose Ministrin e Financave për caktimin e anëtarit të ri të bordit drejtues.

4. Institucionet respektive, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit, sipas pikës 3 të këtij kreu, caktojnë anëtarët e bordit drejtues, duke njoftuar Ministrinë e Drejtësisë. Njoftimi shoqërohet edhe me dokumentacionin e plotë të anëtarit të caktuar, me anë të të cilit provohet plotësimi prej tyre i kushteve të përcaktuara në këtë vendim. Në rastin e anëtarëve të caktuar nga Kryeministri, njoftimi përcillet me shkresë të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave.

5. Ministri i Drejtësisë, brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e njoftimit, sipas pikës 4 të këtij kreu, pasi verifikon plotësimin e kushteve nga ana e anëtarëve të caktuar, i propozon Këshillit të Ministrave miratimin e përbërjes së bordit drejtues, duke propozuar si kryetar të tij njërin nga anëtarët e caktuar nga Kryeministri.

6. Mandati i anëtarëve të bordit drejtues është 4-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje të menjëhershme vetëm një herë.

7. Mandati i anëtarit të bordit drejtues mbaron:

- a) kur jep dorëheqjen;
- b) kur përfundon mandati 4-vjeçar i qëndrimit në detyrë;
- c) kur shkarkohet;
- ç) kur mbush moshën e pensionit;
- d) me vdekjen e tij.

8. Anëtarët e bordit drejtues shkarkohen nga organi që i ka caktuar, në këto raste:

- a) kur ndërpret marrëdhëniet e punës me institucionin që e ka emëruar;
- b) kur dënohet me vendim gjyqësor penal të formës së prerë;
- c) kur nuk merr pjesë, pa arsye, në më shumë se tri mbledhje rresht të bordit drejtues;
- ç) kur bëhet i paaftë mendërisht ose fizikisht për të ushtruar detyrën.

9. Mbarimi i mandatit, për shkakun e përcaktuar në shkronjën “b” të pikës 7 të këtij kreu, i njoftohet Ministrit të Drejtësisë nga Kryeregjistruesi.

Mbarimi i mandatit për shkaqet e përcaktuara në shkronjat “a”, “c”, “ç” dhe “d” të pikës 7 të këtij kreu, i njoftohen Ministrit të Drejtësisë nga organi që ka caktuar anëtarin, duke bërë edhe caktimin e anëtarit të ri, sipas rregullave dhe brenda afateve të përcaktuara në këtë kre.

Ministri i Drejtësisë, pas marrjes së njoftimit, ndjek procedurën e parashikuar në këtë kre, duke propozuar ndryshimet në vendimin e Këshillit të Ministrave që ka miratuar përbërjen e bordit drejtues.

III. Kriteret e për caktimin e anëtarëve të bordit drejtues

1. Anëtarët e caktuar nga Kryeministri duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- a) të kenë shtetësi shqiptare;
- b) të kenë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) njëri nga anëtarët duhet të ketë mbaruar ciklin e dytë të studimeve të larta, në shkencat informatike, ndërsa anëtari tjetër duhet të ketë mbaruar ciklin e dytë të studimeve të larta, në shkencat inxhinierike ose juridike.

ç) nëse është punonjës i Kryeministrisë, të jetë i nivelit të lartë drejtues.

2. Anëtarët e caktuar nga Ministri i Drejtësisë duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- a) të kenë shtetësi shqiptare;
- b) të kenë zotësi të plotë për të vepruar;



c) njëri nga anëtarët duhet të ketë mbaruar ciklin e dytë të studimeve të larta, në degën drejtësi, ndërsa anëtari tjetër duhet të ketë mbaruar ciklin e dytë të studimeve të larta, në shkencat ekonomike ose informatike.

ç) nëse është punonjës i Ministrisë së Drejtësisë, të jetë i nivelit të lartë drejtues.

3. Anëtari i caktuar nga Ministri i Financave duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të ketë shtetësi shqiptare;

b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

c) të ketë mbaruar ciklin e dytë të studimeve të larta, në shkencat ekonomike.

ç) nëse është punonjës i Ministrisë së Financave, të jetë i nivelit të lartë drejtues.

IV. Masa e shpërblimit

1. Kryetari i bordit drejtues merr një shpërblim mujor në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë.

2. Anëtarët e bordit drejtues marrin një shpërblim mujor në masën 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë.

3. Sekretari teknik i bordit drejtues merr një shpërblim në masën 5 000 (pesë mijë) lekë.

4. Shpenzimet për shpërblimin e kryetarit, anëtarëve dhe sekretarit teknik të bordit drejtues, të cilat vërtetohen kundrejt dokumentit të pjesëmarrjes në mbledhje, përballohen nga buxheti i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

V. Dispozita të fundit

1. Ministri i Drejtësisë, brenda 5 (pesë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, cakton anëtarët e bordit drejtues dhe i kërkon Kryeministrit dhe Ministrit të Financave caktimin e anëtarëve të tyre në bordin drejtues.

2. Institucionet respektive, sipas rregullave dhe afateve të përcaktuara në kreun II të këtij vendimi, i njoftojnë Ministrit të Drejtësisë anëtarët e caktuar prej tyre në bordin drejtues.

3. Ministri i Drejtësisë, brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e njoftimit, sipas pikës 2 të këtij kreu, ushtron përgjegjësitë e përcaktuara në pikën 5 të kreut II të këtij vendimi.

4. Bordi drejtues fillon veprimtarinë e tij menjëherë pas fillimit të funksionimit të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme si një institucion me vetëfinancim.

5. Ngarkohen Kryeministri, Ministri i Drejtësisë, Ministri i Financave dhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr. 753, datë 2.11.2012

PËR MIRATIMIN NË PARIM TË MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR TRANSFERIMIN E PERSONAVE TË DËNUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 7 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin, në parim të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për transferimin e personave të dënuar, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE

NDËRMMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR TRANSFERIMIN E PERSONAVE TË DËNUAR

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, në vijim të referuara si “palët”,

duke dëshiruar zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e së drejtës penale;

duke konsideruar se një bashkëpunim i tillë duhet të çojë më tej qëllimet e drejtësisë dhe rehabilitimin social të personave të dënuar;

duke parë se këto objektiva kërkojnë që personave të cilëve u është hequr liria si rezultat i kryerjes të një vepre penale, duhet t’u jepet mundësia të vuajnë dënimin në shoqërinë e tyre;

duke vlerësuar se ky qëllim mund të arrihet më mirë duke i transferuar ata në vendet e tyre, kanë rënë dakord më sa vijon:

Neni 1

Përkufizime

1. Për qëllimet e kësaj marrëveshjeje:

“Dënim” do të thotë çdo dënim përfundimtar apo masë që ka të bëjë me heqjen e lirisë të vendosur nga një gjykatë si rezultat i një vepre penale.

“Vendim” është çdo vendim ose urdhër i gjykatës me të cilin është dhënë dënimi.

“Shteti dënues” është shteti në të cilin është dhënë dënimi për personin, i cili mund të transferohet ose është transferuar;

“Shteti zbatues” është shteti në të cilin personi i dënuar mund ose është transferuar për të vuajtur dënimin.

“Autoritet qendror” janë ministrat e drejtësisë të palëve respektive.

Neni 2

Parime të përgjithshme

1. Palët marrin përsipër t’i ofrojnë njëra-tjetrës masën më të gjerë të bashkëpunimit në lidhje me transferimin e personave të dënuar në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje.

2. Personi i dënuar në territorin e shtetit dënues mund të transferohet në territorin e shtetit zbatues, në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje, për të vuajtur dënimin e dhënë. Për këtë qëllim ai mund të shprehë interesin e tij te shteti dënues ose te shteti zbatues për transferimin e tij në përputhje me këtë marrëveshje.

3. Transferimi mund të kërkohet nga shteti dënues ose nga shteti zbatues.

Neni 3

Kushtet për transferim

1. Personi i dënuar mund të transferohet në bazë të kësaj marrëveshjeje vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:



- i) personi është shtetas i shtetit zbatues;
 - ii) vendimi është i formës së prerë;
 - iii) në kohën e pranimit të kërkesës për transferim, personi i dënuar ka ende të paktën gjashtë muaj burgim nga dënimi për të vuajtur;
 - iv) personi i dënuar jep pëlqimin për transferim ose, duke marrë parasysh moshën ose gjendjen e tij fizike apo mendore dhe, kur njëri prej palëve e konsideron atë si të nevojshme, nëpërmjet përfaqësuesit ligjor të personit të dënuar;
 - v) veprimet apo mosveprimet, në bazë të të cilave është dhënë dënimi, përbëjnë veprë penale sipas legjislacionit të shtetit zbatues ose do të përbënte veprë penale nëse do të ishte kryer në territorin e tij; dhe
 - vi) shteti dënues dhe shteti zbatues janë dakord me transferimin.
2. Në raste të veçanta, palët mund të bien dakord me një transferim edhe nëse koha që duhet të vuajë personi i dënuar është më e shkurtër se ajo e përcaktuar në paragrafin 1 nënparagrafin “iii” të këtij neni.
3. Dispozitat e kësaj marrëveshjeje zbatohen për aq sa është e mundur edhe për personat e papërgjegjshëm penalisht që kanë kryer veprë penale, për të cilët gjykata ka vendosur heqjen e lirisë nëpërmjet shtrimit të detyruar në një institucion psikiatrik.

Neni 4

Detyrimi për të dhënë informacion

1. Çdo person i dënuar për të cilin zbatohet kjo marrëveshje informohet nga shteti dënues mbi përmbajtjen e kësaj marrëveshjeje.
2. Nëse personi i dënuar i ka shprehur interes shtetit dënues për t’u transferuar në përputhje me këtë marrëveshje, ai shtet njofton shtetin zbatues pa vonesë, sapo vendimi ka marrë formë të prerë.
3. Informacioni përfshin:
 - i) emrin, datën dhe vendin e lindjes së personit të dënuar;
 - ii) adresën e tij, nëse ka, në shtetin zbatues;
 - iii) përshkrimin e fakteve mbi të cilat është bazuar dënimi; dhe
 - iv) natyrën, kohëzgjatjen dhe datën e fillimit të dënimit.
4. Nëse personi i dënuar i ka shprehur interesin e vet shtetit zbatues, shteti dënues me kërkesë i komunikon atij shteti informacionin e përmendur në paragrafin 3 të këtij neni.
5. Personi i dënuar informohet me shkrim dhe në gjuhën të cilën ai e kupton për çdo veprim të ndërmarrë nga palët në përputhje me paragrafin 4 të këtij neni, si edhe për çdo vendim të palëve lidhur me kërkesën për transferimin e tij.

Neni 5

Komunikimi

1. Kërkesat dhe përgjigjet për transferim bëhet me shkrim.
2. Komunikimi ndërmjet palëve bëhet drejtpërdrejt midis autoriteteve qendrore, megjithatë komunikimi përmes kanaleve diplomatike nuk përjashtohet.
3. Palët informojnë njëra-tjetrën në kohën e duhur për vendimet e pranimit ose jo për transferimin e kërkuar.

Neni 6

Dokumentet shoqëruese

1. Shteti zbatues i paraqet shtetit dënues, nëse kërkohet prej tij:
 - i) dokument apo deklaratë që tregon se personi i dënuar është shtetas i atij shteti;

ii) kopje të dispozitave ligjore përkatëse të shtetit zbatues, që tregojnë që kryerja apo moskryerja e veprimit për të cilin është dhënë dënimi në shtetin dënues përbën vepër penale, sipas legjislacionit në shtetin zbatues apo përbën vepër penale nëse do të ishte kryer në territorin e tij.

2. Kur kërkohet transferimi, shteti dënues i paraqet dokumentet e mëposhtme shtetit zbatues:

i) një kopje të njësuar të vendimit dhe të ligjit mbi të cilin është bazuar vendimi;

ii) një deklaratë ku tregohet se sa kohë e dënimit është vuajtur, duke përfshirë të dhënat për paraburgimin, shkurtime të dënimeve, si dhe për çdo fakt tjetër të rëndësishëm që ka të bëjë me ekzekutimin e dënimit;

iii) deklaratë që përmban pëlqimin për transferim sipas nenit 3, paragrafit 1, nënparagrafin “iv” të kësaj marrëveshjeje.

iv) Kur është e nevojshme, raport mjekësor apo shoqëror për personin e dënuar, të dhëna lidhur me trajtimin e tij dhe çdo rekomandim tjetër lidhur me trajtimin e tij në shtetin zbatues.

3. Këto dokumente nuk paraqiten nëse një prej palëve ka njoftuar se nuk është dakord me transferimin.

4. Palët, përpara se t'i paraqesin njëra-tjetrës kërkesën për transferimin ose përpara marrjes së vendimit për transferimin, kërkojnë të pajisen me dokumentet e përmendura në paragrafin 2 të këtij neni.

Neni 7

Pëlqimi dhe verifikimi

1. Shteti dënues siguron që personi i dënuar ka dhënë pëlqimin për transferim në përputhje me nenin 3 paragrafi 1 nënparagrafin “iii” dhe e ka bërë këtë me vullnetin e tij dhe në dije të plotë për pasojat, duke përfshirë kushtet e burgimit, shërbimet që ofrohen, të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve në shtetin zbatues. Procedura për dhënien e pëlqimit zbatohet sipas legjislacionit të shtetit dënues.

2. Shteti dënues i jep mundësi shtetit zbatues që të verifikojë nëpërmjet një konsulli ose një zyrtari tjetër, për të cilin është rënë dakord me shtetin zbatues, që pëlqimi është dhënë në përputhje me kushtet e përcaktuara të këtij neni.

Neni 8

Efektet e transferimit në shtetin dënues

1. Marrja përsipër e ekzekutimit të dënimit ndaj personit të transferuar nga autoritetet e shtetit zbatues do të kenë efekt të suspendimit të dënimit në shtetin dënues.

2. Shteti dënues nuk mund të ekzekutojë më tej dënimin, nëse shteti zbatues e konsideron ekzekutimin e dënimit si të përfunduar.

Neni 9

Efektet e transferimit për shtetin zbatues

1. Autoritetet kompetente të shtetit zbatues duhet:

i) të vazhdojë ekzekutimin e dënimit menjëherë ose nëpërmjet një vendimi dënimi sipas kushteve të përcaktuara në nenin 10 të kësaj marrëveshjeje.

ii) të shndërrojë dënimin me anë të një procedure gjyqësore ose administrative në një vendim të atij shteti, duke zëvendësuar kështu sanksionin e dhënë nga shteti dënues me një sanksion të parashikuar nga ligji i shtetit zbatues për të njëjtën vepër penale, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 11 të kësaj marrëveshjeje.

2. Në rast kërkesë, shteti zbatues informon shtetin dënues para transferimit të personit të dënuar, për sa i përket procedurës që do të ndiqet.

3. Ekzekutimi i dënimit rregullohet nga ligji i shtetit zbatues dhe vetëm shteti zbatues është kompetent për të marrë të gjitha vendimet përkatëse.



Neni 10

Ekzekutimi i vazhduar

1. Në rastin e vazhdimit të ekzekutimit, shteti zbatues është i detyruar t'u përmbahet natyrës juridike dhe kohëzgjatjes së dënimit, siç është parashikuar në shtetin dënues.

2. Nëse ky dënim nga natyra ose kohëzgjatja nuk përputhet me ligjin e shtetit zbatues ose kur kjo parashikohet nga ligji i tij, ai shtet, me anë të një urdhri gjyqësor ose administrativ, mund të adoptojë sanksionin me dënimin ose masën e parashikuar nga ligji i vet për veprën penale. Për sa i përket natyrës së tij, dënimi ose masa, nëse është e mundur, duhet të korrespondojë me atë të dhënë nga dënimi për t'u ekzekutuar. Për nga natyra ose kohëzgjatja, ai nuk duhet të rëndojë sanksionin e dhënë nga shteti dënues dhe nuk duhet të kalojë maksimumin e parashikuar nga shteti zbatues.

Neni 11

Konvertimi i dënimit

1. Në rastin e konvertimit të dënimit zbatohen procedurat e parashikuara nga ligji i shtetit zbatues. Kur bëhet konvertimi i dënimit, organi kompetent:

i) duhet t'u përmbahet konstatimeve në lidhje me faktet e përcaktuara shprehimisht ose që nënkuptohen nga vendimi i dhënë nga shteti dënues;

ii) nuk mund të konvertojë një dënim me burgim në një dënim me gjobë;

iii) shkurton periudhën e plotë të heqjes së lirisë së vuajtur nga personi i dënuar;

iv) nuk e rëndon pozitën penale të personit të dënuar dhe nuk është i detyruar t'i përmbahet ndonjë minimumi që mund të parashikojë ligji i vendit zbatues për veprën ose veprat e kryera.

2. Nëse procedura e konvertimit kryhet pas transferimit të personit të dënuar, shteti zbatues e mban atë person të ndaluar ose siguron në ndonjë mënyrë tjetër praninë e tij në shtetin zbatues, derisa të dalë rezultati i procedurës.

Neni 12

Falja dhe amnistia

1. Secili shtet mund të japë falje ose amnisti në përputhje me legjislacionin e tij të brendshëm dhe njofton për këtë shtetin tjetër.

2. Në rast se dënimi falet ose amnistohet nga shteti dënues dhe shteti dënues i dërgon aktet te shteti zbatues, autoriteti qendror i shtetit zbatues procedon sipas legjislacionit të tij të brendshëm.

Neni 13

Rishikimi i vendimit

Vetëm shteti dënues ka të drejtën për të vendosur mbi çdo kërkesë për rishikimin e vendimit.

Neni 14

Përfundimi i ekzekutimit

Shteti zbatues përfundon ekzekutimin e dënimit menjëherë sapo të informohet nga shteti dënues për çdo vendim ose masë, si rezultat i të cilit dënimi duhet të përfundojë.

Neni 15

Informacioni për ekzekutimin

Shteti zbatues i jep informacion shtetit dënues në lidhje me ekzekutimin e dënimit:

i) kur ai e konsideron ekzekutimin e dënimit të përfunduar;

- ii) nëse personi i dënuar është arratisur nga institucioni i vuajtjes së dënimit para përfundimit të ekzekutimit të dënimit; ose
- iii) kur shteti dënues kërkon një raport të veçantë.

Neni 16

Gjuha dhe shpenzimet

1. Në zbatim të kësaj marrëveshjeje, informacionet përcillen në gjuhën zyrtare të palës së kërkuar:

- i) për Republikën e Shqipërisë, në gjuhën shqipe;
- ii) për Republikën e Kosovës, në gjuhën shqipe ose serbe.

2. Përveç kufizimit të parashikuar në nenin 6 paragrafi 2 nënparagrafi “i”, dokumentet e transmetuara në zbatim të kësaj marrëveshjeje nuk nevojiten të njësuar.

3. Shpenzimet e kryera nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje përballohen nga shteti zbatues, përveç shpenzimeve të kryera ekskluzivisht në territorin e shtetit dënues dhe shpenzimet lidhur me transportin e personit të dënuar deri në kufi të shtetit zbatues ose në rast të transportimit ajror, deri në aeroportin e destinacionit përfundimtar, përveç nëse palët vendosin ndryshe.

Neni 17

Dispozitat përfundimtare

1. Kjo marrëveshje i nënshtrohet ratifikimit në përputhje me procedurat ligjore të palëve dhe do të hyjë në fuqi 30 ditë pas njoftimit të fundit, përmes kanaleve diplomatike të palëve se procedurat e brendshme për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje janë përfunduar.

2. Kjo marrëveshje është e zbatueshme për zbatimin e dënimeve të dhëna para ose pas hyrjes së saj në fuqi.

3. Marrëveshja lidhet për një afat kohor të pacaktuar dhe përfundon 6 muaj pasi njëra nga palët njofton palën tjetër për përfundimin e saj.

4. Secila prej palëve mund të kërkojë denoncimin e marrëveshjes, në çdo kohë duke i dërguar njoftim me shkrim palës tjetër nëpërmjet kanaleve diplomatike. Denoncimi i kësaj marrëveshjeje hyn në fuqi 6 muaj pas marrjes së këtij njoftimi. Kjo marrëveshje vazhdon të jetë e zbatueshme për ekzekutimin e dënimeve të personave, të cilët janë transferuar në përputhje me dispozitat e marrëveshjes para datës në të cilën ka hyrë në fuqi denoncimi.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, rregullisht të autorizuar, kanë nënshkruar këtë marrëveshje.

Bërë në Prishtinë, 2012, në gjuhët shqipe dhe serbe, të gjitha tekstet njësoj autentike. Në rast mosmarrëveshjeje në interpretim, teksti në gjuhën shqipe do të ketë përparësi.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
ZËVENDËSKRYEMINISTRI
DHE MINISTRI I DREJTËSISË
Hajredin Kuçi



VENDIM
Nr. 756, datë 6.11.2012

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË
AUTORITETIT KOMBËTAR TË USHQIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 65 të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Genc Juka, drejtor i përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, lirohet nga kjo detyrë.
2. Z. Artan Gjergji emërohet drejtor i përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 758, datë 2.11.2012

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË E
TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE, PËR VEPRIMTARITË E DREJTORISË
SË PËRGJITHSHME TË ARKIVAVE, DHE PËR ORGANIZIMIN E EKSPOZITËS “VESHJE
TË TREVAVE SHQIPTARE” NË KUADËR TË 100-VJETORIT TË PAVARËSISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, në zërin “Projekte”, artikulli 604, t’i shtohet fondi prej 2 620 000 (dy milionë e gjashtëqind e njëzet mijë) lekësh, për veprimtaritë e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi dhe për organizimin e ekspozitës etnografike mbarëkombëtare “Veshje të trevave shqiptare”, që do të zhvillohet në mjediset e Muzeut Historik Kombëtar, me rastin e 100 Vjetorit të Pavarësisë.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
3. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PROJEKTET PËR 100-VJETORIN E PAVARËSISË SË SHTETIT SHQIPTAR

NR.	EMRI I AKTIVITETIT	DATA	VENDI	INSTITUCIONI ZBATUES	SHUMA
1	Ekspozitë "Plava dhe Gucia në 100-vjetorin e Pavarësisë"	27 Korrik	Plavë, Mal i Zi	AQSH	150.000
2	Ekspozitë "Marrëdhëniet Shqiptaro-Ruse në Arkivat e dy vendeve tona"	26 Tetor	Tiranë	AQSH	150.000
3	Ekspozitë "Elbasani në 100-vjetorin e Pavarësisë"	30 Tetor	Elbasan	AQSH	150.000
4	"Transmetimi i kujtesës së Holokaustit dhe parandalimi i krimeve kundër njerëzimit"- Organizuar në kuadër të presidencës së KIE(Konference, ëorkshop).	3-5 Shtator	Tiranë	AQSH	100.000
5	Ekspozitë "Nderi i Njeriut: Shpëtimi i Hebrenjve në Shqipëri"	3-5 Shtator	Tiranë	AQSH	150.000
6	Përrurimi i ekspozitës mbi kontributin ekolonive shqiptare të mërgimit "Diaspora"	19-26 prill	Tiranë	AQSH	150.000
7	Ekspozita "Kontributi i persoaliteve të SH.B.A dhe Britania e Madhe për çështjen shqiptare"	22 tetor	Tiranë	AQSH	150.000
8	Ekspozitë "Kontributi i personaliteteve nga Franca dhe Gjermania për çështjen Shqiptare".	5 nëntor	Tiranë	AQSH	150.000
9	Ekspozitë "Kontributi i personaliteteve nga Austro-Hungaria dhe Italia për çështjen shqiptare".	12 nëntor	Tiranë	AQSH	150.000
13	Katalogët e ekspozitave		Tiranë	AQSH	300.000
14	"Arkivi Shqiptar" – Revistë Shkencore	Nëntor	Tiranë	AQSH	200.000
15	Katalogët e ekspozitës "Dorëshkrime Bizantine dhe Pashizantine në Shqipëri"	Nëntor	Tiranë	AQSH	100.000
16	SHUMA TOTALE				1,900,000 lekë

VENDIM

Nr. 768, datë 7.11.2012

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE TË KRITEREVE PËR SHPËRNDARJEN E FONDIT TË KOMPENSIMIT PRONARËVE, NË TË HOLLA, PËR VITIN 2012

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 11 pika 1 shkronja "d", e 17 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar, dhe të pikës 1 të nenit 5 të ligjit nr.10239, datë 25.2.2010 "Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave", me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Subjektet e shpronësuar, prona e të cilave është njohur për kompensim, të kompensohen sipas radhës kronologjike, të përcaktuar nga numri dhe data e vendimit, vetëm nëse përmbushen këto kritere:

- Vendimi, që ka përcaktuar kompensimin e pronës, është përfundimtar;
- Vendimi, që ka përcaktuar kompensimin e pronës, është i ekzekutueshëm;
- Vendimi, për të cilin aplikohet, nuk është trajtuar asnjëherë me kompensim.

Në rastin e vendimeve të cilat janë ndryshuar pjesërisht, për efekt klasifikimi, do të merret numri dhe data e vendimit bazë, që është më i hershëm në radhë kronologjike, për njohjen, kthimin dhe kompensimin e asaj prone.



2. Kompensimi të bëhet për pronën e llojit truall, në bazë të çmimit të përcaktuar në hartën e vlerës, të miratuar sipas vendndodhjes së pronës që kompensohet. Masa e kompensimit të jetë sipas skemës së mëposhtme:

a) Për pronat e njohura për kompensim deri në 1500 (një mijë e pesëqind) m², masa e kompensimit të jetë deri në 200 (dyqind) m².

b) Për pronat e njohura për kompensim mbi 1500 (një mijë e pesëqind) m² deri në 3000 (tre mijë) m², masa e kompensimit të jetë 300 (treqind) m².

c) Për pronat e njohura për kompensim mbi 3000 (tre mijë) m² deri në 5000 (pesë mijë) m², masa e kompensimit të jetë 400 (katërqind) m².

ç) Për pronat e njohura për kompensim mbi 5000 (pesë mijë) m² deri në 10000 (dhjetë mijë) m², masa e kompensimit të jetë 500 (pesëqind) m².

d) Për pronat e njohura për kompensim mbi 10000 (dhjetë mijë) m², masa e kompensimit të jetë 600 (gjashtëqind) m².

3. Subjektet, që kanë depozituar kërkesat e tyre në vitet 2006, 2007, 2008, 2009 dhe 2011 dhe që vërtetojnë kryerjen e pagesës, nuk paguajnë tarifën e aplikimit për vitin 2012.

4. Subjekti duhet të plotësojë dhe të paraqesë pranë AKKP-së dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesën për kompensim në të holla, sipas formularit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) deklaratën për pranimin e kriterëve për kompensim dhe të kushteve të tjera që lidhen me to, sipas formularit 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

c) titullin për njohjen dhe kompensimin e pronës, që, sipas rastit, mund të jetë vendim i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, vendim i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, si dhe vendim i gjykatës, në rastet kur vendimet e sipërpërmendura janë ndryshuar në rrugë gjyqësore;

ç) planvendosjen përkatëse të vendimit, si edhe planin e rlevimit të pronës së njohur për kompensim në fragmentin e hartës treguese të regjistrimit të pasurive të paluajtshme;

d) dëshminë e trashëgimisë;

dh) nëse disponon, prokurë të posaçme, të nënshkruar nga të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm, në ato raste kur pjesët takuese nuk janë të përcaktuara në vendimin e KKP-së/ZRAKKP-së;

e) vendimet e KKP-së/ZRAKKP-së ku janë përcaktuar pjesët takuese të secilit bashkëpronar.

ë) çdo akt tjetër gjyqësor apo administrativ me anë të të cilëve provohet pjesa takuese e secilit bashkëpronar.

f) dokumentin e identifikimit (letërnjoftim apo pasaportë) të përfaqësuesit të pajisur me prokurë;

g) mandatpagesën.

5. Në rastin e kërkesave të paraqitura në AKKP, në mbështetje të vendimeve të Këshillit të Ministrave nr.1343, datë 4.6.2008 “Për miratimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit të pronarëve, në të holla, për vitin 2008”, nr.487, datë 6.5.2009 “Për përcaktimin e rregullave dhe të kriterëve për shpërndarjen e fondit të kompensimit, të pronarëve, në të holla, për vitin 2009”, dhe nr.192, datë 9.3.2011 “Për përcaktimin e rregullave dhe të kriterëve për shpërndarjen e fondit të kompensimit, pronarëve, në të holla, për vitin 2011”, të cilat nuk janë pranuar nga AKKP-ja për pamjaftueshmëri fondi, kërkuesit duhet të pohojnë vullnetin e tyre, nëpërmjet një kërkesë të re, për kompensimin, të shoqëruar me dokumentet e parashikuara në pikën 6 të këtij vendimi.

6. Subjektet që kanë aplikuar për kompensimin në të holla, në vitet 2008, 2009 dhe 2011, të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesën për kompensim financiar, sipas formularit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) deklaratën për pranimin e kriterëve për kompensim dhe të kushteve të tjera që lidhen me to, sipas formularit 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

c) dëshminë e trashëgimisë, nëse ka ndryshime në rrethin e trashëgimtarëve të ligjshëm të subjektit të shpronësuar, sipas radhës së trashëgimtarëve, të përcaktuar në Kodin Civil.

ç) Prokurën e posaçme, nëse ajo e paraqitur në vitin 2008, 2009 apo 2011 ka kufizimin në kohë për tagrin e tërheqjes së shumës në të holla apo kur rrethi i trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar ka ndryshuar.

7. AKKP-ja shqyrton dokumentacionin e subjekteve që kërkojnë kompensim në të holla, duke kryer veprimet e mëposhtme:

a) Verifikon dosjen dhe vendimin përkatës, të dhënë nga Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

b) Kërkon nga zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, që, brenda 10 (dhjetë) ditëve, të konfirmojnë, për:

i) regjistrimin e vendimit përkatës në ZVRPP;

ii) përcaktimin e gjendjes juridike aktuale të pronës dhe verifikimin nëse ajo ka ndryshuar nga momenti i daljes së vendimit me të cilin aplikohet;

iii) verifikimin e ushtrimit të së drejtës së parablerjes.

c) Kryen verifikimin në terren të gjendjes së pronës dhe mban procesverbalin përkatës.

ç) Përgatit planvendosjen e pronës që kompensohet dhe cakton:

i) në hartën e vlerës, zonën ku ndodhet prona;

ii) në bashkëpunim me subjektin e shpronësuar, pjesën e pronës, që kërkohet për t'u kompensuar, sipas masës që përcaktohet në pikën 2 të këtij vendimi, dhe i kërkon përfaqësuesit me prokurë të nënshkruajë për pjesën që kompensohet.

d) Llogarit vlerën e sipërfaqes, që kompensohet.

dh) Përgatit vlerësimin ligjor, ku shpjegohen me hollësi për secilin subjekt kërkuar:

i) vlefshmërinë e vendimit të paraqitur nga kërkuar;

ii) konfirmimet e zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme;

iii) vlerësimin e pronës për kompensim.

e) Merr vendimin për pranimin apo refuzimin e kërkesës për kompensim të subjektit të shpronësuar.

ë) U dërgon subjektit të shpronësuar, Avokaturës së Shtetit dhe zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme kopje të vendimeve të marra, për t'u dhënë mundësi të ushtrojnë kompetencat ligjore.

f) Shpall listën e subjekteve fituese.

g) Kryen veprimet me thesarin dhe bankën për kalimin e fondit të kompensimit, në të holla, në emër të subjektit të shpronësuar, përfitues të kompensimit, apo përfaqësuesit të tij me prokurë, në përputhje me procedurat për zbatimin e buxhetit të shtetit.

8. Procesi i regjistrimit/pranimin të kërkesave për kompensim fillon 5 (pesë) ditë pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe vazhdon për 1 (një) muaj.

9. Procesi i trajtimit të kërkesave të subjekteve të shpronësuar duhet të kryhet në përputhje me këtë vendim dhe me afatin ligjor, të përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 17 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar.

10. Paraqitja e të dhënave të rreme ose fshehja e tyre nga subjektet e shpronësuar, në zbatim të këtij vendimi, sjell përjashtimin e menjëhershëm të këtyre subjekteve nga procedura e kompensimit në të holla dhe i ngarkon ata me përgjegjësi penale, sipas legjislacionit në fuqi.

11. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



Formulari tip 1

K Ë R K E S Ë

Për kompensimin e pronës

Drejtuar: AGJENCISË SË KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE

Data e paraqitjes së kërkesës ____ / ____ / 2012

Subjekti i shpronësuar :

.....
Emri Atësia Mbiemri

Personi me prokurë që paraqet kërkesën:

.....
Emri Atësia Mbiemri

Adresa e personit me prokurë:

.....
Qarku Rrethi Qyteti/Fshati

.....
Lagja Rruga Nr.i banesës

.....
Telefon Celular e-mail

Kërkoj kompensimin e pronës me të holla, sipas kriterëve të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.____, datë ____/____/2012, “Për përcaktimin e rregullave dhe të kriterëve për shpërndarjen e fondit të kompensimit, pronarëve, në të holla për vitin 2012”.

Körkuesi

.....
(emri, atësia, mbiemri, nënshkrimi)

Shënim! Ky formular është dokument zyrtar. Paraqitja e të dhënave të rreme ose fshehja e tyre passjell përjashtimin e menjëhershëm nga çdo procedurë e mëtejshme, si dhe përgjegjësi penale sipas ligjit.

Formulari tip 2

DEKLARATË

Personi me prokurë që paraqet kërkesën :

Emri
Atësia
Mbiemri

Adresa e personit me prokurë :

Qarku	Rrethi	Qyteti/fshati
-------	--------	---------------

Lagja	Rruga	Nr.i banesës
-------	-------	--------------

.....

Në emër të trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar, sipas prokurës së posaçme të bashkëlidhur, deklaroj se:

1. Në rast se nuk shpallem fitues, sipas kriterëve të përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.____, datë ____ / ____ / 2012, “Për përcaktimin e rregullave dhe të kriterëve për shpërndarjen e fondit të kompensimit, pronarëve, në të holla për vitin 2012”, tërhiqem nga kërkesa e paraqitur për kompensimin në të holla për vitin 2012.
2. Heq dorë nga e drejta e parablerjes për sipërfaqen e kompensuar, në rast se shpallem fitues në këtë aplikim.



3. Nuk kam përfituar nga kompensimet e mëparshme si në të holla ashtu dhe fizike, për pronën e njohur me vendimin me të cilin aplikoj.
4. Nuk jam në proces gjyqësor, apo proces shqyrtimi të një ankimi administrativ në lidhje me pronën objekt kompensimi.
5. Deklaroj që të gjithë trashëgimtarët ligjorë të subjektit të shpronësuar, të cilët përfaqësoj me prokurë, janë gjallë.

Kjo deklaratë i bashkëlidhet kërkesës nr. _____, datë ____ / ____ /2012, për kompensim në të holla për vitin 2012.

Deklaruesi (përfaqësuesi me prokurë)

.....
(emri, atësia, mbiemri, nënshkrimi)

Shënim! Ky formular është dokument zyrtar. Paraqitja e të dhënave të rreme ose fshehja e tyre passjell përjashtimin e menjëhershëm nga çdo procedurë e mëtejshme, si dhe përgjegjësi penale sipas ligjit.

VENDIM

Nr. 801, datë 14.11.2012

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE, PËR REALIZIMIN E TRI KONCERTEVE, MË 28 NËNTOR 2012, ME RASTIN E 100-VJETORIT TË PAVARËSISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, t’i shtohet fondi prej 157 836 000 (njëqind e pesëdhjetë e shtatë milionë e tetëqind e tridhjetë e gjashtë mijë) lekësh, për realizimin e tri koncerteve që do të zhvillohen në datën 28 nëntor 2012, me rastin e 100-Vjetorit të Pavarësisë.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

KËRKESË

Nr. 4675, datë 8.11.2012

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Tiranë-Elbasan” (loti I + loti III): kultura bujqësore, dru frutorë dhe dru dekorativë.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar (ish-DPRR). Me anë të këtij publikimi në shtyp, kërkohet të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 23.3.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përlllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”.

Pronarët që kanë emrat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Sqarojmë që kjo shpallje kërkesë për shpronësim bëhet vetëm për pasurinë e llojit kultura bujqësore, dru frutorë dhe dru dekorativë.

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e shpronësimit është 15 309 188 (pesëmbëdhjetë milionë e treqind e nëntë mijë e njëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë.

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT

Sokol Olldashi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PASURIVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “TIRANË- ELBASAN”
(LOTI I + LOTI III) (KULTURAT BUJQËSORE, DRUFRUTORË DHE DRU DEKORATIVË)

Nr.	Emër , atësia mbiemër	Nr. i pasurisë	Z.K.	Sip. (m ²)	Kulturë bujqësore vlera lekë	Kulturë drufrutorë vlera lekë	Dru dekorative vlera lekë	Totali lekë	Shënime
	Fshati Mjull Bathore, komuna Farkë								
1	Enver Begu	255/3	2704	2658		189950		189950	Konf. ZRPP
2	Beqir Kadri Husha	532/19	2704	4790		278259		278259	Konf. ZRPP
3	Pasha Kadri Husha	531/2	2704	3151		213342		213342	Konf. ZRPP
4	B/pronaret Husha	533/2	2704	4696		357981		357981	Konf. ZRPP
5	B/pronaret Husha	538/4	2704	4975		334200	1247500	1581700	Konf. ZRPP
6	Enver Braja	163/26	3266	550		80700		80700	Konf. ZRPP
7	Fatmir Hasan Husha	531/1	2704	2110		666250		666250	Konf. ZRPP
8	Viktor Frroku	537/8	2704	500			39000	39000	Konf. ZRPP
	Fshati Lundër, komuna Farkë								
1	Pellumb & Ismet Krraba	538/28	2529	514			323200	323200	Konf. ZRPP
	Fshati Mullet, komuna Petrelë								
1	Haki Teqja	218/15	2735	1597	6400	294390		300790	Konf. ZRPP
2	Mersin Teqja	218/14	2735	1166		110650		110650	Konf. ZRPP
3	Eshref Teqja	218/30	2735	3725	32725			32725	Konf. ZRPP
4	Lulzim Teqja	218/28	2735	1774	14192			14192	Konf. ZRPP
5	Hysen Haxhiu	217/43	2735	478	2176			2176	Konf. ZRPP
6	Naim Haxhiu	217/46	2735	1256	10048			10048	Konf. ZRPP
7	Ramazan Haxhiu	217/1, 212/2	2735	2327		282290		282290	Konf. ZRPP
8	Qamil Haxhiu	217/31/1	2735	2554	20432			20432	Konf. ZRPP
9	Hysni Haxhiu	217/41, 212/1	2735	3510		248400		248400	Konf. ZRPP
10	Qemal Muka	217/44	2735	286		39850		39850	Konf. ZRPP
	Fshati Fikas, komuna Petrelë								
1	Bajram Kerciku	23/1	1622	1927	15416			15416	Konf. ZRPP
2	Ramazan Beka	23/2	1622	1906	18669			18669	Konf. ZRPP
3	Haziz Kerciku	23/25	1622	679	5576			5576	Konf. ZRPP
4	Kurt Kerciku	23/13	1622	1271	10168			10168	Konf. ZRPP
5	Myslym Kerciku	23/27	1622	1015	8120			8120	Konf. ZRPP
6	Enver Islam Tocila	23/15	1622	3570	29060			29060	Konf. ZRPP
	Fshati Berzhitë, komuna Berzhitë								
1	Rukie Sulejman Stafa (Gjuzi)	223/25	1170	7030		194575		194575	Konf. ZRPP
2	Bashkim Sallaku	222/22	1170	2168		475000		475000	Konf. ZRPP
3	Gezim Sefer Sallaku	222/21	1170	992		200000		200000	Konf. ZRPP
4	Albert Shefqet Gjuzi	126/71	1170	790		85000		85000	Konf. ZRPP
5	Fiqiri Besim Gjuzi	126/75	1170	519		150300		150300	Konf. ZRPP
6	Qazim Xhemal Gjuzi	126/61	1170	1476	8896	74400		83296	Konf. ZRPP
7	Fiqiri Besim Gjuzi	126/79	1170	902		275270		275270	Konf. ZRPP
8	Shefqet Xhemal Gjuzi	126/45	1170	1375		101600		101600	Konf. ZRPP
9	Hamit Veli Gjuzi	126/49	1170	1424	10079			10079	Konf. ZRPP
10	Seit Selman Gjuzi	126/83	1170	1453	11897			11897	Konf. ZRPP
11	Kasem Tahir Muja	122/3, 122/4	1170	1169		143050		143050	Konf. ZRPP
12	Skender Selman Gjuzi	71/10	1170	232		22000		22000	Konf. ZRPP
13	Hasan Hysen Gjime	71/13	1170	2716		193500		193500	Konf. ZRPP
14	Kasem Asllani	45/13	1170	1628		115700		115700	Konf. ZRPP
15	Mynyr Shehu	45/14	1170	1475		105650		105650	Konf. ZRPP
16	Stavro Spiro Thanati	222/29	1170	162		29100		29100	Konf. ZRPP
17	Nazmi Sefer Sallaku	222/44	1170	1354		226700		226700	Konf. ZRPP
	Fshati Mushqeta, komuna Krabë								
1	Musa Velia	3/1	2752	808	9292			9292	Proces regjistrimi

2	Kadife Rama	3/2	2752	3027	34810		34810	Konf ZRPP
3	Zini Rama	3/10	2752	2690	26245		26245	Konf ZRPP
4	Tefik Rama	3/11	2752	2822	31242		31242	Proces rregjistrimi
5	Ramazan Velia	3/9	2752	1408		51400	51400	Konf ZRPP
6	Xhevit Ajazi	3/8	2752	734	8441		8441	Proces rregjistrimi
7	Ismail Velia	3/4	2752	75	862		862	Konf ZRPP
8	Defrim Velia	3/6	2752	678	7797		7797	Konf ZRPP
9	Musa Velia	4/2/5	2752	1152	13248		13248	Konf ZRPP
10	Gani Karafili	4/2/1	2752	3950	41475		41475	Proces rregjistrimi
11	Sinan Karafili	4/2/2	2752	4677	51447		51447	Proces rregjistrimi
12	Sali Ajazi	21/8	2752	223	2564		2564	Proces rregjistrimi
13	Besim Karafili	4/2/3	2752	4148	36800		36800	Proces rregjistrimi
14	Zyber Tarja	19/2	2752	617	7095		7095	Proces rregjistrimi
15	Sanije Velia	19/3	2752	1304	13692		13692	Proces rregjistrimi
16	Xhemal Lika	14/1	2752	1218	14007		14007	Konf ZRPP
17	Arben Lika	14/6	2752	1865	20515		20515	Konf ZRPP
18	Bajram Basha	14/2	2752	2376	27324		27324	Proces rregjistrimi
19	Bashkim Lami	45/7	2752	655	7532		7532	Proces rregjistrimi
20	Fatmir Bafti	45/15	2752	698	7678		7678	Proces rregjistrimi
21	Qazim Tarja	45/10	2752	2517	35238		35238	Proces rregjistrimi
22	Xhemal Sallufi	45/11	2752	426		76900	76900	Proces rregjistrimi
23	Fiqiri Bafti	45/12	2752	670		12000	12000	Proces rregjistrimi
24	Fadil Velia	58/2	2752	1250		145100	145100	Proces rregjistrimi
25	Mustafa Tarja	58/3	2752	1460	16060		16060	Proces rregjistrimi
26	Zyber Tarja	58/4	2752	542		118700	118700	Proces rregjistrimi
27	Sali Tarja	51	2752	766	8426		8426	Proces rregjistrimi
28	Osman Tafa	54	2752	274	3151		3151	Proces rregjistrimi
	Fshati Mamel, komuna Gracen							
1	Ali Haka	235/3	2583	326		77200	77200	Proces rregjistrimi
2	Ali Haka	284, 285	2583	3108		677700	677700	Proces rregjistrimi
3	Isuf Stafa	280, 281	2583	2526		345920	345920	Proces rregjistrimi
4	Durim Skora	278	2583	1784		84600	84600	Proces rregjistrimi
5	Halil Dopi	316/3	2583	448	9900	10820	20720	Proces rregjistrimi
6	Skender Stafa	279	2583	1348		98020	98020	Proces rregjistrimi
7	Sulejman Dopi	203/7	2583	1130		30250	30250	Proces rregjistrimi
8	Ramazan Mallosi	202	2583	3024	22500	10500	33000	Proces rregjistrimi
9	Sali Dopi	203/4	2583	903		32880	32880	Proces rregjistrimi
10	Hamdi Skora	278/4	2583	2255		209836	209836	Proces rregjistrimi
11	Beshir Skora	272/11	2583	1270		11200	11200	Proces rregjistrimi
	Fshati Shëngjin, komuna Gracen							
1	Qazim Llozi	380/4	3346	674		76500	76500	Proces rregjistrimi
2	Ismail Llozi	374/5	3346	574		79730	79730	Proces rregjistrimi
3	Shefqet Qosja	260	3346	326		66100	66100	Proces rregjistrimi
4	Zeqir Hasa	384/1	3346	547		72500	72500	Proces rregjistrimi
5	Ali Hasa	382/4	3346	1672		149400	149400	Proces rregjistrimi
	Fshati Ulem, komuna Bradashesh							
1	Osman Sula	68/1	3674	1500		6300	6300	Proces rregjistrimi
2	Agim Sula	69/3	3674	336	7000		7000	Proces rregjistrimi
3	Osman Sula	69/8	3674	1176		41600	41600	Proces rregjistrimi
4	Shefqet Sula	69/10	3674	488	17100		17100	Proces rregjistrimi
5	Ruzhdi Sula	79/21	3674	1717	13440		13440	Proces rregjistrimi
	Fshati Shtemaj, komuna Bradashesh							
1	Ibrahim Meta	238/6	3419	1500	30000		30000	Konf. ZRPP
2	Adile Myzyri	103/1	3419	78	680		680	Konf. ZRPP
3	Nazmi Allhasa	105/4	3419	1291	15510		15510	Konf. ZRPP
4	Musa Allhasa	104/3	3419	709	8550		8550	Konf. ZRPP
5	Qerim Allhasa	106/6	3419	927		338000	338000	Konf. ZRPP
6	Zylyf Allhasa	106/5	3419	300	3600		3600	Konf. ZRPP
7	Riza Sula	106/2	3419	189	2680		2680	Konf. ZRPP
8	Musa Allhasa	107/1	3419	538	6600		6600	Konf. ZRPP
9	Riza Sula	107/2	3419	702	9800		9800	Konf. ZRPP
10	Jonuz Sula	107/3	3419	500	7000		7000	Konf. ZRPP
11	Nazmi Allhasa	110/1	3419	606	8480		8480	Konf. ZRPP
12	Qazim Allhasa	111/1	3419	1000		60700	60700	Konf. ZRPP
13	Shaqir Sula	111/7	3419	500	7000		7000	Konf. ZRPP
14	Qazim Allhasa (trashëg)	111/17	3419	990	12000		12000	Konf. ZRPP
15	Sulejman Allhasa	111/2	3419	500	7000		7000	Konf. ZRPP
16	Ismail Sula	111/3	3419	700	9800		9800	Konf. ZRPP



17	Riza Sula	111/8	3419	500	7000		7000	Konf. ZRPP
18	Rrapush Myzyri	111/5	3419	128	2520		2520	Konf. ZRPP
19	Shaqir Allhasa(trasheg)	110/2	3419	200	2800		2800	Konf. ZRPP
20	Ismail Sula	111/10	3419	232	3240		3240	Konf. ZRPP
21	Qamil Allhasa(trasheg)	111/18	3419	1490	18000		18000	Konf. ZRPP
22	Shaqir Allhasa(trasheg)	111/12	3419	1000	12000		12000	Konf. ZRPP
23	Sadik Meta	111/13	3419	1000	14000		14000	Konf. ZRPP
24	Ramazan Meta	111/15, 16, 123/2	3419	1498	21000		21000	Konf. ZRPP
25	Qazim Allhasa	123/5	3419	2000		187500	187500	Konf. ZRPP
26	Xhemal Myzyri	125/1, 127/2	3419	2200	26400		26400	Konf. ZRPP
27	Muhamet Myzyri	125/2	3419	2000		210000	210000	Konf. ZRPP
28	Bashkim Hasa	125/3	3419	1000	12000	22500	34500	Konf. ZRPP
29	Muhamet Myzyri	127/1	3419	236		42000	42000	Konf. ZRPP
30	Nezir Meta	136/7	3419	1390	10680		10680	Konf. ZRPP
31	Ibrahim Meta	136/6	3419	1500	15900		15900	Konf. ZRPP
32	Sali Kusi	136/4	3419	418	5840		5840	Konf. ZRPP
Fshati Reçan, komuna Bradashesh								
1	Ibrahim Gava	42/2	3161	91		6000	6000	Konf. ZRPP
2	Hava Zena	40	3161	371		25620	25620	Konf. ZRPP
3	Shaqir Gava	96	3161	542	6600		6600	Konf. ZRPP
4	Skender Minsku	100	3161	450		36000	36000	Konf. ZRPP
5	Mustafa Topalli	106	3161	3461	30000	69000	99000	Konf. ZRPP
6	Ismail Misku	135	3161	810		72000	72000	Konf. ZRPP
7	Ismail Misku	139	3161	728	10220		10220	Konf. ZRPP
8	Skender Minsku	141	3161	775		44000	44000	Konf. ZRPP
9	Halil Sharra	172	3161	1800		35000	35000	Konf. ZRPP
10	Ismail Sharra	168	3161	250		17500	17500	Konf. ZRPP
11	Ismail Misku	164	3161	1080		48000	48000	Konf. ZRPP
12	Petrit Sharra	163/3	3161	539		37800	37800	Konf. ZRPP
13	Skender Sharra	163/4	3161	579		40320	40320	Konf. ZRPP
Fshati Shijon, komuna Bradashesh								
1	Agim Terziu	5/11	3371	515	18000		18000	Proces rregjistrimi
2	Jani Preni	5/9	3371	1153		104400	104400	Proces rregjistrimi
3	Vladimir Toli	5/8	3371	816	28600		28600	Proces rregjistrimi
4	Thoma Toli	5/7	3371	459	8260		8260	Proces rregjistrimi
5	Dhespina Ranxha	5/2	3371	592		41000	41000	Proces rregjistrimi
6	Ilia Ranxha	9/23	3371	469	8440		8440	Proces rregjistrimi
7	Agim Ranxha	9/21	3371	566	19800		19800	Proces rregjistrimi
8	Dhimiter Gega	9/20	3371	699	12580		12580	Proces rregjistrimi
9	Josif Ranxha	9/18	3371	512		46900	46900	Proces rregjistrimi
10	Avran Gjika	9/17	3371	1082		108400	108400	Proces rregjistrimi
11	Vladimir Preni	9/15	3371	585		80700	80700	Proces rregjistrimi
12	Ligor Gjika	9/13	3371	609	9135		9135	Proces rregjistrimi
13	Anastas Preni	11/36	3371	587		63700	63700	Proces rregjistrimi
14	Agim Gjika	11/20	3371	1112		44000	44000	Proces rregjistrimi
15	Jorgji Ranxha	11/8	3371	288		29000	29000	Proces rregjistrimi
16	Vasil Toli	36/31	3371	260		35140	35140	Proces rregjistrimi
17	Josif Terziu	36/27	3371	1214		114200	114200	Proces rregjistrimi
18	Ilia Toli	36/26	3371	825		86470	86470	Proces rregjistrimi
19	Peter Toli	36/25	3371	866		78520	78520	Proces rregjistrimi
20	Jani Gega	36/24	3371	865		61240	61240	Proces rregjistrimi
21	Ilia Gega	36/23	3371	821		51360	51360	Proces rregjistrimi
22	Vasil Hala	36/22	3371	856		67500	67500	Proces rregjistrimi
23	Jani Hala	36/21	3371	986		93000	93000	Proces rregjistrimi
24	Sokrat Toli	36/17	3371	997		143000	143000	Proces rregjistrimi
25	Jovan Toli	36/14	3371	829		32725	32725	Proces rregjistrimi
26	Vladimir Preni	36/12	3371	917		46000	46000	Proces rregjistrimi
27	Jani Gega	38/14	3371	2293		214600	214600	Proces rregjistrimi
Fshati Bradashesh, komuna Bradashesh								
1	Risto Toci	61/26	1258	2022	28280	23450	51730	Konf. ZRPP
2	Emine Rakipi	61/25	1258	1890	22680		22680	Konf. ZRPP
3	Spiro Toci	61/24	1258	3505	21040	111000	132040	Konf. ZRPP
4	Venemin Toci	61/23	1258	2755		603000	603000	Konf. ZRPP
5	Osman Bahiti	61/32	1258	283		14100	14100	Konf. ZRPP
6	Astrit Korca	61/33	1258	362		18000	18000	Konf. ZRPP
7	Jace Korca	61/34	1258	226		11250	11250	Konf. ZRPP
8	Bajram Meta	61/8	1258	521	7280		7280	Konf. ZRPP

9	Hysni Bajrami	61/6	1258	528		24675		24675	Konf. ZRPP
10	Ali Tingja	61/5	1258	186	2250			2250	Konf. ZRPP
11	Rexhep Bajrami	61/4	1258	500	7000			7000	Konf. ZRPP
12	Kodhel Bajrami	61/3	1258	330	4600			4600	Konf. ZRPP
13	Hamit Haka	61/2	1258	371	4470			4470	Konf. ZRPP
14	Rrapush Balla	61/1	1258	1271	18000			18000	Konf. ZRPP
15	Shyqyri Takia	61/19	1258	2350		139620		139620	Konf. ZRPP
16	Idriz Korca	61/18	1258	1200		180000		180000	Konf. ZRPP
17	Avni Spahiu	61/36	1258	800	11200			11200	Konf. ZRPP
18	Neki Spahiu	61/17	1258	900	12600			12600	Konf. ZRPP
19	Kurt Balliu	61/16	1258	1700	20400			20400	Konf. ZRPP
20	Haki Biba	61/15	1258	1750		104400		104400	Konf. ZRPP
21	Ferit Allkja	61/13	1258	2500	30000			30000	Konf. ZRPP
22	Refat Kuminja	61/11	1258	1302	15000			15000	Konf. ZRPP
23	Mustafa Balla	61/10	1258	622	7500			7500	Konf. ZRPP
24	Nexhip Bitri	62/11	1258	675	21000			21000	Konf. ZRPP
25	Ramazan Bitri	62/10	1258	715	21000			21000	Konf. ZRPP
26	Ramazan Bitri	62/9	1258	924	11100			11100	Konf. ZRPP
27	Demir Bitri	62/8	1258	1100	13200			13200	Konf. ZRPP
28	Rrapush Lleshanaku	62/7	1258	1587	22240			22240	Konf. ZRPP
29	Agim Lleshanaku	62/6	1258	304	3660			3660	Konf. ZRPP
30	Gani Lleshnaku	62/5	1258	191	11520			11520	Konf. ZRPP
31	Kadri Xhija	62/19	1258	1432	17160			17160	Konf. ZRPP
32	Emine Tafa	62/18	1258	821	9900			9900	Konf. ZRPP
33	Hasan Kuminja	62/17	1258	875	10500			10500	Konf. ZRPP
34	Rrapush Lleshanaku	62/16	1258	1774	21300			21300	Konf. ZRPP
35	Gani Lleshanaku	62/14	1258	959	2250			2250	Konf. ZRPP
36	Nevruz Lleshanaku	62/13	1258	652		39000		39000	Konf. ZRPP
37	Dylaver Lleshanaku	62/12	1258	326		113160		113160	Konf. ZRPP
38	Selman Lleshanaku	62/1	1258	203	3195			3195	Konf. ZRPP
				251495.0	1510775	12188713	1609700	15309188	

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QBZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 21.11.2012
Doli nga shtypi më 21.11.2012

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8
---------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 36 lekë